



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës



Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË – FURNIZIM

KONTRATA NR.022/2019

Përshkrimi i Kontratës: **Furnizimi me material ndërtimor për ndërtim te shtëpive.**

NUMRI I PROKURIMIT: **642-19-2994-1-1-1**

NUMRI I BRENSHEM : **642/19/022/111**

AUTORITETI KONTRAKTUES: **KOMUNA E MITROVICËS**

OPERATORI EKONOMIK: **NNP “UNIVERSAL” Faik HASANI B.I.-Mitrovicë**

DATA E NËSHKRIMIT: **15/07/2019**

KONTRATA - Furnizimi me material ndërtimor për ndërtim te shtëpive.

AUTORITETI KONTRAKTUES: **KOMUNA E MITROVICËS**

dhe

OPERATORI EKONOMIK: **NNP "UNIVERSAL" Faik HASANI B.I.-Mitrovicë**

TITULLI I KONTRATËS:

Furnizimi me material ndërtimor për ndërtim te shtëpive.

REFERENCA E PROKURIMIT: NR iprokurimit: **642-19-2994-1-1-1**

REFERENCA E PROKURIMIT: NR brendsh: **642/19/022/111**

Neni 1 Lënda

Lëndë e kontratës është Puna, nga operatori ekonomik i punëve në vijim për autoritetin kontraktues:

Furnizimi me material ndërtimor për ndërtim te shtëpive.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi i Furnizimi me material ndërtimor për ndërtim te shtëpive.

Qmimi TOTAL: **195.463,00€ (Njëqindë nëntëdhjet e pë mijë katërqindë e gjashtë e tri euro 00/100) .**

Specifikimi i çmimit të O.E fitues i bashkangjitet kesaj kontrate.

Kohzgjatja e kesaj kontrate publike është 36 muaj furnizim me material ndertimor ku parashifet afati i LIFERIMIT, sipas planit te liferimit dhe kërkesave nga ana e Komunës së Mitrovicës (Drejtoria e DUPH) .

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i vendosur dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

Neni 3 Afatet dhe kushtet e kontratës

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2, kjo kontratë e ka afatin kohor prej 60 ditë pune dhe kjo kontrollonhet nga organi mbiqyres i Autoritetit Kontraktues.

Neni 4 Dokumentacioni përbërës dhe plotësues i kontrates sipas prioritetit

Kontrata përbëhet nga dokumentet e mëposhtme, sipas prioritetit:

- Kontrata

- Marrëveshja e kontratës;

- Kushtet e Veçanta,;

- Tenderi i Kontraktuesit,;

- Oferta financiare;



- Kushtet e Përgjithshme;

- Procesverballi i takimit informues/vizita e vendit dhe dispozitat tjera të dosjes së tenderit;


Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose shmangjes, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.



Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe/ose Zyrtarit të Prokurimit, nga njëra anë, dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit, dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht sipas nenit 4 në Kushtet e Veçanta.

E hartuar në gjuhën shqipe në Katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues: Komuna e Mitrovicës ; 40000 Mitrovicë	
Emri:	Haxhimet FERATI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	15/07/2019
Vula:	

[Ne rast te kontratave me vlere te madhe]

Emri:	Agim BAHTIRI
Pozita:	Kryetar i KOMUNËS -- Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	15/07/2019
Vula:	

Për Kontraktorin: Grup i Operatorëve Ekonomik: NNP "UNIVERSAL" Faik HASANI B.I.- Mitrovicë	
Emri:	Faik HASANI
Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:	
Data:	15/07/2019
Vula:	

KJO KONTRATË ËSHTË PUNUAR NË KATËR KOPJE ORIGJINALE PËR SECILIN PALË NGA NJË ORIGJINAL

1. Drejtoria e Prokurimit
2. Drejtoria përkatëse e kërkeses Drejtoria e Shëndetsisë
3. Operatori Ekonomik pala nënshkruese: **NNP "UNIVERSAL" Faik HASANI B.I.-Mitrovicë**
4. Drejtoria për Buxhet e Financa

Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në tenderin e tij GJUHA SHQIPE.

PJESA E KONTRATËS - III - KUSHTET E VEÇANTA**PËRMBAJTJA**

Këto kushte përforcojnë dhe plotësojnë, nëse është e nevojshme, Kushtet e përgjithshme që udhëheqin kontratën. Përveç nëse Kushtet e veçanta lejojnë ndryshe, Kushtet e përgjithshme mbeten plotësisht të zbatueshme. Numërimi i neneve të Kushteve të veçanta nuk është konsektiv por i përmbahet numërimit të neneve në Kushtet e përgjithshme. Në raste të veçanta, dhe me autorizim të departamenteve kompetente të Komisionit, mund të përfshihen edhe klauzola tjera për të mbuluar situata specifike.

Neni 1. Përkufizimet	Neni 23. Suspendimi
Neni 2. Gjuha dhe ligji i aplikueshëm	Neni 24. Cilësia e Punëve
Neni 3. Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës	Neni 25. Inspektimi dhe testimi
Neni 4. Komunikimi	Neni 26. Parime të përgjithshme
Neni 5. Transferimi	Neni 27. Pagesat për palët e treta
Neni 6. Nën-kontraktimi	Neni 28. Vonesa e pagesës
Neni 7. Dhënia e dokumenteve	Neni 29. Dorëzimi
Neni 8. Ndihma lidhur me rregulloret vendore	Neni 30. Operacionet e verifikimit
Neni 9. Obligimet e përgjithshme	Neni 31. Pranimi i përkohshëm
Neni 10. Prejardhja	Neni 32. Obligimet për garanci
Neni 11. Siguria e ekzekutimit	Neni 33. Punët pas-shitjes
Neni 12. Sigurimi	Neni 34. Pranimi përfundimtar
Neni 13. Programi i realizimit	Neni 35. Shkelja e kontratës
Neni 14. Skicat e Kontraktuesit	Neni 36. Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues
Neni 15. Mjaftueshmëria e çmimeve të tenderit	Neni 37. Ndërprerja nga ana e Kontraktuesit
Neni 16. Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën	Neni 38. Forca madhore
Neni 17. Patentat dhe licencat	Neni 39. Vdekja
Neni 18. Rendi i fillimit	Neni 40. Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve
Neni 19. Kontrata të përmbushet në afatin e caktuar	Neni 41. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore
Neni 20. Zgjatja e periudhës së ekzekutimit	Neni 42. Klauzolat etike
Neni 21. Vonesat e ekzekutimit	Neni 43. Dënimet administrative dhe financiare
Neni 22. Variacionet	Neni 44. Kontrollat dhe auditimet

Nr i prokurimit: **642-19-2994-1-1-1**;Nr i brendshëm **642/19/022/111**- Furnizimi me material ndërtimor për raste sociale dhe për ndërtim te shtëpive.

Neni 1. Përkufizimet

Sipas Kushteve te pergjithshme te Kontrates neni 1.

Neni 2. Gjuha dhe Ligji i aplikueshëm

- 2.1 Ligji i Prokurimit Publik dhe Ligjet tjera të aplikueshme ne Kosovë zbatohet për çështjet që nuk mbuloohen me dispozita të kontratës.
2.2 Gjuha që përdoret do të jetë: Shqipe

Neni 3. Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

Sipas nenit 4, Pjesa I (e parë) e Kontratës.

Neni 4. Komunikimi

Emri i AK:	KOMUNA E MITROVICËS	Personi kontaktues:	Haxhimet FERATI
e-mail	prokurimi.mitrovica@rks-gov.net	e-mail:	nexhmi.hasani@rks-gov.net
Menaxher	HAXHIMET FERATI	Menaxher i projektit	Nexhmi HASANI
Adresa :	VII. Dragaj	Kodi postar	40 000
Qyteti:	MITROVICË	Regjioni	Mitrovicë
Telefoni:	038/200-42 045	Fax	N/A

Emri i OE:	NNP UNIVESAL Faik HASANI B.I.	Personi kontakt:	Faik HASANI
		e-mail:	univesal@hotmail.com
Adresa :	Ibrahim POPOVCI 29	Kodi postar	40000
Qyteti:	40000 Mitrovicë	Regjioni	Mitrovicë
Telefoni:	044/174-865	Fax	N/A

Komunikimi mes palëve do te behet ne formen e shkruar ne leter ose me post elektronike, faks e ne pamundesi te komunikimeve te tilla edhe me telefon.

Neni 5. Transferimi

Transferimi i Kontratës nga ana e Kontraktorit te ndonjë palë tjetër nuk lejohet pa pëlqimin e Autoritetit Kontraktues. Por edhe nëse merret pëlqimi nga Autoriteti Kontraktues ai do të jetë valid vetëm për pikat e cekura sipas nenit 5, Kushteve të Përgjithshme të Kontratës.

Neni 6. Nën-kontraktimi

Nën-kontraktimi lejohet vetën deri në vlerën prej 40% të vlerës së përgjithshme të kontratës dhe me këtë rast duhet të prezantohet marrveshja e nënshkruar mes kontraktorit dhe nën-kontraktorit, ku definojnë aspektet dhe vëllimi i nën-kontraktimit.

Nr i prokurimit: **642-19-2994-1-1-1**;Nr i brendshëm **642/19/022/111**- **Furnizimi me material ndërtimor për raste sociale dhe për ndërtim te shtëpive.**

Neni 7. Dhënia e dokumenteve

Sipas nenit 7, të Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës - Pjesa II (e dytë) e Kontratës.

Neni 8. Ndihma lidhur me rregulloret vendore

Autoriteti Kontraktues obligohet që me kërkesën e Kontraktorit, në afat sa më të shkurt, atë ta pajisë me Ligje dhe Rregullore vendore të cilat cilat janë të domosdoshme për realizimin e kontratës pa pengesa, ose ta drejtojë atë në adresën e saktë ku më së shpejti mund t'i realizojë kërkesat e tijë.

Neni 9. Obligimet e përgjithshme

Kontraktuesi duhet ti përmbahet ofertës së dhënë si dhe specifikimeve në dosjen e tenderit si dhe obligimeve sipas nenit 9 të Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës.

Neni 10. Prejardhja (Nëse Aplikohet)

Mallrat e përdorur gjatë punës duhet të jenë të pajisur me certifikatë e cila dëshmon kualitetin dhe prejardhjen, në të kundërtën nuk do të pranohet nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 11. Sigurimi i ekzekutimit të kontratës

[Sigurimi i ekzekutimit 10 % Të SHUMES TOTALE TË TENDERIT NË AFAT 37 MUAJ PAS DATES SE NENSHKRIMIT TE KONTRATES 15/07.2019 DERI ME 15/07.2022.](#)

Neni 12. Sigurimi

Nëse aplikohet sigurimi i mallit atëherë duhet të bëhet në pajtim me nenin 12 të Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës.

Neni 13. Programi i realizimit

Kontraktori duhet t'i kryej të gjitha obligimet në pajtim me planin dinamik/afatet kohore prej momentit kur leshohet vendimi për zbatim nga organet komunale ne afat 3 ditëve pune të cekur në ofertën e tij, në dosjen e tenderit apo të aprovuar nga Menaxheri i Projektit për çdo kërkesë të pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14. Skicat e Kontraktuesit

Nëse nga Autoriteti Kontraktues kërkohen skica, vizatime apo mostra të produkteve të cilat duhet duhet liferuar, të gjitha këto kontraktori obligohet ti dorëzoj ashtu siç është specifikuar në dosjen e tenderit.

Neni 15. Mjaftueshmëria e çmimeve të tenderit

Autoriteti Kontraktues do të nënshkruaj kontratën vetëm pasi të vërtetohet se oferta e kontraktorit potencial është e pranueshme dhe në vete përmban të gjitha obligimet (DDP). Për çfarëdo ndryshimesh të cilat nuk mund të arsyetohen shpenzimet shtesë i bartë vet Kontraktori.

Neni 16. Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

Të gjitha obligimet lidhur me tatimin dhe doganën per mallin që duhet liferuar i bartë Kontraktori në pajtim me ligjet e aplikueshme ne vend.

Neni 17. Patentat dhe licencat

Të gjitha licencat dhe patentet e nevojshme për përmblylljen e kontratës me sukses janë obligim i kontraktorit.

Neni 18. Rendi i fillimit

Procedura e punës duhet koordinuar mes Menaxherit të Projektit dhe Kontraktorit ashtu që të plotësohen konditat e pranimit sipas rendit me prioritet/kapacitetit punues.

Neni 19. Kontrata të përmbushet në afatin e caktuar

Nr i prokurimit: 642-19-2994-1-1-1;Nr i brendshëm 642/19/022/111- Furnizimi me material ndërtimor për raste sociale dhe për ndërtim te shtëpive.

Afatet per përmbushjen e Kontratës është 36 MUAJ, liferimet fillojn brenda 5 ditëve pas nenshkrimit te kontrates ajo duhet te filloj te zbatohet ne tërësi sipas kërkesave te Komunës dhe DUPH.

Neni 20. Zgjatja e afatit për përmbushje të kontratës

Zgjatja e afateve te realizimit te kërkesave(kontrates) behet ne koordinim ne mes te Autoritetit Kontraktues (Projekt Menaxherit) dhe Kontraktorit, me nje arsytim te plote te dorëzuar me shkrim nga ana e Kontraktorit dhe te aprovuar nga Projekt Menaxheri.

Neni 21. Vonesat në ekzekutim

Për çfarëdo vonesash të cilat nuk pranohen nga Menaxheri i Projektit Autoriteti Kontraktues do t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së punëve të pa dorëzuara/realizuar deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.

Neni 22. Variacionet

Çdo variacion i mundshëm duhet të jetë në pajtim me nenin 22 të Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës mirëpo në asnjë mënyrë nuk guxon të tejkalon vlerën prej 10% nga vlera totale e kontratës.

Neni 23. Suspendimi

Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën që për shkaqe të arsyeshme të pezullojë liferimin e caktuar duke u bazuar në nenin 23 të KPK, brenda afatit të vlefshmërisë së ofertës apo të vlefshmërisë së sigurimit të ekzekutimit.

Neni 24. Cilësia e Punëve

Punët duhet të jenë në pajtim me specifikimet e kërkuara në dosje të tenderit dhe t'i përmbushin kushtet dhe standardet për punët të cilat janë objekt i kontratës.

Neni 25. Inspektimi dhe testimi

Inspektimi dhe testimi i punëve behet nga Projekt Menaxheri/Komisioni pranues për çdo material dhe periudhë të punës.

Neni 26. Parime të përgjithshme - Pagesat

PAGESAT BËHEN SIPAS FURNIZIMEVE TË KRYERA DHE SI DHE SITUACIONIT DHE RAPORTEVE TË APROVUARA DHE TE NENSHKRUARA NGA ORGANI MBIKQYRES DHE MENAXHERI I PROJEKTIT.

Neni 27. Pagesat për palët e treta

Nëse aplikohen pagesat për palët e treta do të bëhen në pajtim me nenin 27 të Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës.

Neni 28. Vonesa e pagesës

Nëse kontraktuesi nuk ka ndalesa te cekura sipas nenit 43 të Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës, çdo vonesë të pagesës nga ana e Autoritetit Kontraktues e cila nuk është kryer në pajtim me nenin 26 të KVK dhe KPK, mund ta realizojë sipas nenit 28 të KPK.

Neni 29. Dorëzimi

Dorëzimi i punëve te cilat janë objekt i kontratës behet nga ana e kontraktorit te Menaxheri i projektit i caktuar nga Autoriteti Kontraktues. Dorezimi duhet të kryhet ne pajtim me nenin 13 të Kushteve të Veçanata të Kontratës. Çdo dorëzim duhet te bëhet me fletëdërgesë.

Neni 30. Operacionet e verifikimit

Autoriteti Kontraktues do të bëjë verifikimin dhe testimin e punëve me rastin e dorëzimit nga ana e kontraktorit. Ky verifikim dhe testim nënkupton përmbajtjen/përshtatjen e punëve te liferuara me specifikat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe/apo certifikatat/atestet e dorëzuara nga kontraktuesi.

Neni 32. Obligimet për garanci

Garancioni vlen deri ne ditën e pranimit teknik te punimeve nga Komisioni i pranimit teknik, para pranimit teknik te gjitha dobesit e shfaqura duhet te rregullohen per tu bërë pranimi teknik i punimeve.

Neni 31. Pranimi i përkohshëm

Pranimi i përkohshëm mund të bëhet nëse drejtëpërdrejtë ndikojnë rrethanat e punës apo deponimit dhe në koordinim mes Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktues dhe ne kete rast çdo pranim i tillë duhet të pranohet si i përkohëshëm dhe duhet të leshohet çertifikat e pranim/dorezimit të përkohëshëm, mirëpo çdo gjë duhet të jetë pajtim me nenin 30 të KVK dhe nenin 31 të KPK.

Neni 33. Punët pas-shitjes (Nuk aplikohen)

Nr i prokurimit: 642-19-2994-1-1-1;Nr i brendshëm 642/19/022/111- Furnizimi me material ndërtimor për raste sociale dhe për ndërtim te shtëpive.

Shërbimat pas-shitjes nënkuptojnë: Pjesët rezervë..... etj .

Neni 34. Pranimi përfundimtar

Pranimi përfundimtar bëhet pas përfundimit të punimeve të cilat janë pranuar përkohësisht sipas nenit 31 të KVK) dhe pasi të jenë kryer verifikimet, testimet dhe pranimet me raporte zyrtare të nënshkruara nga Menaxheri i projektit/Komisioni pranues. Punët të cilat nuk kanë pranuar përfundimtar nuk konsiderohen të pranuar. Ky nen plotësohet me nenin përkatës nga KPK.

Neni 35. Shkelja e kontratës

Mos-përbushja e kontratës nga ana e Kontraktorit sipas: afateve, sasisë, kualitetit etj, nënkupton se kontraktori ka dështuar në realizimin e kontratës në termet e caktuara dhe do të aplikohen masa ndëshkuese në pajtim me Kontratën dhe Ligjin e Prokurimit.

Neni 36. Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

Nëse për arsye të caktuara (të cekura në nenin 36 të KPK) kontrata nuk është e realizueshme, Autoriteti Kontraktues me paralajmërim prej 7 ditësh mund ta ndërprejë Kontratën me Kontraktorin, mirëpo paraprakisht duhet siguruar se Kontraktori e ka pranuar njoftimin me kohë.

Neni 37. Ndërprerja nga ana e Kontraktuesit

Nëse për arsye të caktuara (të cekura në nenin 37 të KPK) kontrata nuk është e realizueshme, Kontraktori me paralajmërim prej 14 ditësh mund ta ndërprejë Kontratën me Autoritetin Kontraktues, mirëpo paraprakisht duhet siguruar se Autoriteti Kontraktues e ka pranuar njoftimin me kohë.

Neni 38. Forca madhore

Sipas nenit 38 të Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës.

Neni 39. Vdekja

Sipas nenit 39 të Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës.

Neni 40. Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

Për çfarëdo mosmarrëveshesh në mes palëve kontraktuese palët duhet me komunikim me shkrim duhet të njoftohen dhe në afat prej 15 ditësh të gjejnë zgjidhje për mosmarrëveshjet e cekura. Në rast se nuk mund të zgjidhen këto mosmarrëveshje në këtë afat, atëherë duhet që në afatin shtesë prej 15 ditësh të caktohen komisionet dypalëshe dhe vendimet e këre takimeve duhet të mbulohen me procesverbale zyrtare.

Neni 41. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

Nëse nuk është e mundur që mosmarrëveshjet mes palëve kontraktuese të zgjedhen në mënyrë miqësore atëherë zgjedhja e mosmarrëveshjeve duhet të transferohet në mënyrë institucionale përmes gjykatave kompetente.

Neni 42. Klauzolat etike

Sipas nenit 42 të Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës.

Neni 43. Dënimet administrative dhe financiare

Nëse Kontraktuesi zbulohet se ka pasur dështim serioz që t'i plotësojë obligimet e veta kontraktuese, ai do të pësojë dënime financiare sipas nenit 21 të KVK, deri në [10] % të vlerës totale të kontratës në fjalë. Kjo përqindje mund të rritet në [20] % në rast të përsëritjes së shkeljes brenda pesë vitesh pas shkeljes së parë.

Neni 44. Kontrolllet dhe auditimet

Autoriteti kontraktues do t'i lejojë Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës të verifikojë, duke ekzaminuar dokumentet ose përmes kontrolleve të befasishme, implementimin e kontratës dhe të bëjë një auditim të plotë, nëse është i nevojshëm, në bazë të dokumenteve plotësuese për llogaritë, dokumentet e kontabilitetit dhe ndonjë dokument tjetër që është me rëndësi për financimin e kontratës. Këto inspektime mund të bëhen edhe deri në [7 vite] pas pagesës finale.

Neni 45. Klauzola shtesë

Në rast të çfarëdo paqartësisht Kushtet e Veçanta plotësohen me Kushtet e Përgjithëshme të Kontratës dhe Ligjin e Prokurimit Publik.

Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit: 15/07/2019